



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik

01 - Nr. 16-16363/14  
Kaçanik, 18.07.2014

Në mbështetje të nenit 12.2 (d) - Për Vetëqeverisjen Lokale, të nenit 58 të Rregullores për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 18.07.2014, mori,

**VENDIM**  
**PËR APROVIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT**  
**PËR REKOMANDIMET ZBATUESE NË RAPORTIN VJETOR TË AUDITIMIT 2013**

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Veprimit 01Nr. 16-16363/14 për zbatimin e Rekomandimeve në Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2013, i propozuar nga Kryetari i Komunës, prej datës 30.06.2014.
2. Në Planin e Veprimit si në pikën 1. të këtij vendimi, janë paraqitur veprimet që do t'i merr Kryetari i Komunës dhe zyrtarët tjerë përgjegjës për zbatimin e Rekomandimeve dhe afati kohor për të gjeturat e pasqyruara si në raportin e auditorit, dhe i njëjti është pjesë përbërse e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen, Kryetari i Komunës dhe zyrtarët tjerë përgjegjës të përcaktuar si në Planin e Veprimit.

**Me këtë vendim njoftohen:**

1. Zyra e Kryetarit të Komunës / përmes kësaj njoftohen zyrtarët tjerë përgjegjës-zbatues të Planit të Veprimit,
2. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, dhe
3. Arkivi.



Kryesuesi i kuvendit,  
Xhelal Gashi